



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr.12, datë 18.05.2026

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 7,
DATË 22.02.2023 “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS
KANALIZIME GJIROKASTËR SH.A”

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (*Ligji nr. 8102*), VKM nr.958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë"(VKM nr.958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (*Rregullore e licencimit*),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 18.05.2026 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit "Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 7, datë 22.02.2023 "Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër sh.a".

Konstatohet se:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër sh.a me shkresën nr.679 prot, datë 31.03.2026 dhe plotësimet me shkresën nr.859/1 prot, datë 22.04.2026 me lëndë "Dërgim dokumentacioni për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik", ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (*ERRU*) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik të shoqërisë të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, e ndryshuar;
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (*KKRR*) e gjeti paraqitjen e kërkesës së Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër sh.a për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit, e ndryshuar.

3. KKRR ka licencuar Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjyrokastër me vendimin nr. 7, datë 22.02.2023 "Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjyrokastër, me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik dhe largimit të ujërave të ndotura.
4. Drejtues teknik i shoqërisë në vendimin nr.7, datë 22.02.2023 "Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjyrokastër sh.a", ishte z.Bashkim Tola i diplomuar në Universitetin Politeknik, në profilin Inxhinieri e Shpimit të Puseve, viti 1997, i cili në këtë aplikim është zëvendësuar nga znj. Çelestina Dajlani, Inxhinierë Hidroteknike e diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, viti 2013. Znj. Dajlani ka një eksperiencë mbi 10 vjeçare në sektorin UK, prej vitit 2015 ka qenë Inxhinierë në Drejtorinë Teknike, të ish shoqërisë UK Gjyrokastër sh.a, më pas Përgjegjëse e Kontrollit të Humbjeve dhe Menaxhimit të Projekteve, pranë SHRUK Gjyrokastër sh.a dhe së fundmi mban pozicionin e Drejtorit Teknik pranë kësaj shoqërie. Znj. Dajlani plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.
5. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjyrokastër sh.a të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958, dhe Rregullores së Licencimit, e ndryshuar, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efiçencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e SHRUK Gjyrokastër sh.a është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Gërma b, e pikës 2, e vendimit të KKRR-së nr. 7, datë 22.02.2023 "Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjyrokastër sh.a" bëhet si më poshtë:

b) Drejtues Teknik - znj. Çelestina Dajlani

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Gerta Lubonja